




GARA SHKETËRORE NE  
SHKENCAT NATYRORE për  
klasët e VI  
(përgjigjet)  
(07.qershor 2026)

1. Në një qark elektrik janë lidhur në seri dy llamba A dhe B. Pastaj, është shtuar llamba C siç tregohet në figurë. Të gjitha llambat janë të barabarta.



- A) Çfarë ndodhi me intensitetin e ndriçimit të llambave A dhe B pasi është shtuar llamba C?
- a) llambat A dhe B do të ndriçojnë si më parë
  - b) llambat A dhe B do të ndriçojnë më pak se më parë**
  - c) llambat A dhe B do të ndriçojnë më shumë se më parë
- B) Çfarë do të ndodhë nëse njëra nga llambat ndalon së punuari?
- a) të gjitha llambat do të ndalojnë së ndriçuari**
  - b) dy llambat tjera do të ndriçojnë më fort
  - c) dy llambat tjera do të ndriçojnë më pak
  - d) dy llambat tjera do të ndriçojnë njësoj si më parë
- C) Nëse bateria zëvendësohet me bateri me tension dy herë më të madh, si do të ndryshojë ndriçueshmëria e llambave?
- a) ato do të ndriçojnë më fort**
  - b) ato do të ndriçojnë më dobët
  - c) nuk do të ketë ndryshim
  - d) do të ketë ndryshim vetëm tek disa nga llambat
- D) Si janë renditur llambat sipas ndriçueshmërisë?
- a)  $A > B > C$
  - b)  $C > B > A$
  - c)  $B > A > C$
  - d)  $B > A = C$
  - e)  $A = B > C$
  - f)  $A = B = C$**

(1 pikë për secilën pyetje)

4 pikë

2. Një çiklist lëviz përgjatë një shtegu dhe kalon nëpër pikat A, B, C, D dhe E. Në pika të ndryshme është matur energjia e tij e lëvizjes.

Pika	Energjia e lëvizjes $E$ (J)
A	20
B	80
C	60
D	40
E	40

A) Në cilën pikë çiklisti ka shpejtësi më të madhe? (rretho) A **B** C D E

**(1 pikë)**

B) Pas pikës C, forca e rezistencës së ajrit që vepron mbi çiklistin u rrit. Cila nga shkaqet e mëposhtme mund ta ketë shkaktuar këtë? Rrethoni të gjitha përgjigjet e sakta.

**a) Çiklisti e ka zbërthyer xhakët dhe ajo ka filluar të valëvitet.**

b) Çiklisti është përkulur më afër timonit.

**c) Çiklisti i ka hapur krahët anash.**

**d) Çiklisti ka vendosur një shportë të madhe në pjesën e përparme të biçikletës.**


e) Çiklisti ka veshur një bluzë sportive të lëmuar në vend të xhakëtës.

f) Çiklisti ka filluar të zbriste përgjatë kodrës.

**(3 pikë)**

B) C) Në sistemin koordinativ më poshtë, vizatoni se si ndryshon energjia e lëvizjes së çiklistit kur ai lëviz nga A në E. (Ju duhet ti shënoni pikat A, B, C, D dhe E dhe t'i lidhni ato me një vijë.)

**(gjithsej 3 pikë: pikat e shënuara saktë 2 pikë, të lidhura me një vijë 1 pikë)**



**7 pikë**

3. Nxënësit kanë hulumtuar se nga çfarë varet forca e fërkimit. Për këtë qëllim, ata përdorën trup prej druri dhe një dinamometër. Së pari, ata e kanë tërhequr trupin përgjatë një sipërfaqe druri të njëjtë, duke i shtuar ngarkesa të ndryshme. Ata kanë fituar rezultatet e mëposhtme:

Pesha e trupit (N)	Forca e fërkimit (N)
2	0,5
4	1,0
6	1,5
8	2,0

Pastaj ata e kanë tërhequr të njëjtin trup përgjatë sipërfaqeve të ndryshme dhe kanë fituar:

Sipërfaqja	Forca e fërkimit (N)
Plastikë	1,2
Dru	2,0
Letër grirëse	3,8

Në fund, nxënësit e kanë kthyer trupin në mënyrë që sipërfaqja e kontaktit e tij bëhet dy herë më e madhe, por pesha dhe mbështetësja mbetën të njëjta.

Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:

A) Çfarë mund të përfundohet nga tabela e parë? **(1 pikë)**

- a) Forca e fërkimit nuk varet nga pesha e trupit.
- b) Forca e fërkimit zvogëlohet me rritjen e peshës.
- c) Forca e fërkimit rritet me rritjen e peshës.**
- d) Forca e fërkimit është gjithmonë e barabartë me peshën e trupit.

B) Në cilën sipërfaqe/mbështetëse forca e fërkimit është më e madhe? **(1 pikë)**

- a) plastike
- b) dru
- c) letër grirëse**
- d) është e njëjtë në të gjitha sipërfaqet

C) Nëse forca e fërkimit para rrotullimit ishte 3 N, sa do të jetë përafërsisht pasi trupi të kthehet në anën tjetër? **(2 pikë)**

- a) 1,5 N
- b) 3 N**
- c) 6 N
- d) 12 N

D) Nga cilat madhësi varet forca e fërkimit? \_\_\_\_\_ (2 pikë)

**6 pikë**

**(2 pikë: nga pesha e trupit dhe ashpërsia e materialit (pranohet edhe masa e trupit). 1 pikë, nëse është vetëm një ose nëse ka shënuar edhe ndonjë madhësi tjetër, për shembull pesha, ashpërsia dhe sipërfaqja)**

4. Biçikleta dhe automobili që lëvizin me të njëjtën shpejtësi kah njëri-tjetri përplasen ballë për ballë.

A) Në cilin automjet vepron forcë më e madhe gjatë përplasjes? **(1 pikë)**

- a) Në biçikletë vepron forcë më e madhe
- b) Në automobil vepron forcë më e madhe
- c) Te të dyja vepron forcë e njëjtë**
- d) Nuk mund të them pa me pasur më shumë informacione

B) Cili automjet fiton nxitim më të madh gjatë përplasjes? **(1 pikë)**

- a) biçikleta**
- b) nxitimi është i barabartë
- c) automobile
- d) Është e pamundur të thuhet pa ditur shpejtësinë dhe masën përfundimtare të të dyjave

C) Pse njëri automjet fiton nxitim më të madh? **(1 pikë)**

- a) Sepse në të vepron forcë më e madhe.
- b) Sepse ka masë më të vogël.**
- c) Sepse lëvizën më shpejt para përplasjes.
- d) Sepse ka më masë më të madhe.

**3 pikë**

5. Në tabelën e mëposhtme, shkruaj pranë secilës veti nëse është veti fizike apo kimike.

**(VËREJTJE:** Vetëm përgjigjja e plotë për secilin çift në tabelë vlerësohet me 1 pikë.)

Përçueshmëria e nxehtësisë	<b>Fizike</b>
Magnetizmi	<b>Fizike</b>

Aftësia për tu djegur	<b>Kimike</b>
Fortësia	<b>Fizike</b>

Tretshmëria	<b>Fizike</b>
Aftësia për t'u ndryshkur	<b>Kimike</b>

**3 pikë**

6. Ke në dispozicion një shufër prej druri, një prej diamanti dhe një prej bakri në formë cilindrike, të gjitha me përmasa identike. Po shqyrton vetinë e përçueshmërisë së nxehtësisë. Eksperimentin e kryen duke marrë dy shufra (nga një në secilën dorë) dhe duke i zhytur në të njëjtën gjatësi në një gotë me ujë të valë. Nxjerr përfundim se cila nga dy shufrat e çiftit nxehet e para. Plotëso tabelën më poshtë duke shkruar në hapësirat përkatëse shufrën që është nxehur e para.

(VËREJTJE: Vetëm përgjigjja e plotë për secilën kolonë vlerësohet me 1 pikë.)

	Bakri	Diamanti	Druri
Bakri		<b>Diamanti</b>	<b>Bakri</b>
Diamanti	<b>Diamanti</b>		<b>Diamanti</b>
Druri	<b>Bakri</b>	<b>Diamanti</b>	

3 pikë

7. Cili nga ndryshimet e mëposhtme *nuk është ndryshim* fizik?

- a) Formimi i pikave të ujit në pasqyrën e ftohtë të banjës pas dushit.
- b) zverdhja e gjevethëve tek drunjët gjethërnëse në vjeshtë**
- c) Zvogëlimi i masës së akullnajave gjatë periudhës së verës.
- d) Tharja e letrës filtruese të njomur me acetone.
- e) Bluarja e specit.

1 pikë

8. Po e studion tretshmërinë e substancave të paraqitura në tabelën më poshtë në ujë. Nga secila substancë vendos nga një lugë çaji në një gotë që përmban 250 mL ujë. Plotëso kolonën që i referohet pamjes së përzierjes (e kthjellët ose e turbullt).

	Pamja e përzierjes
Krip	<b>E kthjellët</b>
Rërë e imët	<b>E turbullt</b>
Soda bikarbon	<b>E kthjellët</b>

3 pikë

9. Како што веќе знаете, мозokot на човекот е поделен на лева и десна хемисфера. Kaj повеќето Siç e dini tashmë, truri i njeriut është i ndarë në hemisferën e majtë dhe të djathtë. Te shumica e njerëzve, hemisfera e majtë është më e rëndësishme për të folurit (formimin e fjalive, zgjedhjen e fjalëve dhe kuptimin e domethënies së asaj që thuhet). Hemisfera e djathtë merr më shumë pjesë në detyra vizuo-hapësinore (orientimi në hapësirë dhe njohja e formave), muzika dhe njohja e tonit emocional në të folur (nëse dikush flet me gëzim, trishtim ose zemërim). Të dy hemisferat nuk punojnë veçmas, por vazhdimisht shkëmbejnë informacione përmes një strukture të quajtur trupi kalloz (lidhja ndërhemisferike e trurit).

Ndarja e funksioneve midis dy hemisferave shihet më qartë përmes gjuhës. Te shumica e njerëzve që janë djathtakë (ata që përdorin më shpesh dhe më lehtë dorën e djathtë), funksionet gjuhësore përpunohen kryesisht në hemisferën e majtë. Këtu gjenden zona e Brokës për formimin e të folurit (të folurit) dhe zona e Vernikut për kuptimin e të folurit. Në rast të një goditjeje në tru, këto zona mund të dëmtohen dhe të shfaqen vështirësi në të folur.


Duke përdorur informacionet në tekst dhe njohuritë tuaja, përgjigjuni me e saktë ose e pasaktë.

Te shumica e njerëzve (që përdorin më shpesh dhe më lehtë dorën e djathtë), zona e Brokës ndodhet në hemisferën e djathtë në pjesën frontale të trurit.	S	J
Te shumica e njerëzve (që përdorin më shpesh dhe më lehtë dorën e djathtë), zona e Vernikut ndodhet në hemisferën e majtë në pjesën e lobit temporal të trurit.	S	J
Te shumica e njerëzve (që përdorin më shpesh dhe më lehtë dorën e djathtë), gjatë dëmtimit në pjesën frontale të hemisferës së majtë të trurit, shfaqen vështirësi në kuptimin e domethënies së asaj që është thënë.	S	J
Te shumica e njerëzve (që përdorin më shpesh dhe më lehtë dorën e djathtë), gjatë dëmtimit në lobin temporal të hemisferës së majtë të trurit, shfaqen vështirësi në shqiptimin e fjalive.	S	J
Te shumica e njerëzve (që përdorin më shpesh dhe më lehtë dorën e djathtë), gjatë dëmtimit të hemisferës së djathtë zakonisht nuk shkatërrohet aftësia për kuptimin dhe formimin bazë të të folurit.	S	J
Te shumica e njerëzve (që përdorin më shpesh dhe më lehtë dorën e djathtë), dëmtimi i hemisferës së djathtë zakonisht rezulton në probleme me intonacionin, tonin emocional dhe humorin.	S	J
Te shumica e njerëzve (që përdorin më shpesh dhe më lehtë dorën e majtë), funksionet gjuhësore përpunohen kryesisht në hemisferën e majtë.	S	J

7 pikë

10. Në figurën më poshtë është paraqitur një rrjet i thjeshtë ushqimor në një ekosistem ujor. Në të marrin pjesë organizmat e mëposhtëm:

- |                    |                           |
|--------------------|---------------------------|
| 1- Bimë ujore      | 5- Krap (peshq të vegjël) |
| 2- Fitoplankton    | 6- Troftë                 |
| 3- Zooplankton     | 7- Kormorantë             |
| 4- Larva insektesh | 8- Parazit i kormorantit  |



**Figura 1:** Rrjet i thjeshtë ushqimor

Në këtë rrjet, energjia dhe lëndët ushqyese transferohen nga prodhuesit te konsumatorët. Disa organizma, si larvat e disa insekteve, ushqehen me algat e vdekura, ndërsa disa lloje krimbesh parazitojnë në zorrët e kormoranit.

**A) Shikoni me kujdes figurën 1 dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:**

Në rritjen ushqimor të paraqitur, sa më së shumti anëtarë mund të ketë zinxhiri më i gjatë ushqimor?	<b>6</b>
Në fushën e zbrazët në të djathtë, shkruani numrin e organizmit që përfaqëson zbërthyesin .	<b>4</b>

2 pikë

**B) Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme me e saktë S ose e jo e saktë J.**

Zvogëlimi i popullatës së peshqve krapri mund të çojë në rritjen e nivelit të algave në liqen.	S	<b>J</b>
Nëse në liqen futet një lloj gaforreje që ushqehet me vezët e krapit, atëherë popullata e kormoranëve vihet në rrezik.	<b>S</b>	J
Nëse me analizë të ujit të këtij liqeni është konstatuar prania e një sasive të madhe të Atrazinës (pesticid që përdoret në bujqësi), atëherë sasia më e madhe e atrazinës do të gjendet te kormoranët.	<b>S</b>	J

3 pikë

Nëse vlera energjetike e një peshku krapri është 250 kcal (kilokalori), llogaritni sa pjesë e kësaj energjie do të transferohet në nivelin e ardhshëm trofik (troftat), dhe sa pjesë e energjisë do të transferohet te shpendët kormoranët!

<p><b>Për përgjigje të saktë pranohet:</b></p> <p><b>Troftat do të marrin vetëm 10% të energjisë së nivelit trofik të mëparshëm (energjinë nga krapit):</b></p> <p><b><math>250 \text{ kcal} \times 10\% = 25 \text{ kcal}</math></b></p> <p><b>ose</b></p> <p><b><math>250 \text{ kcal} \div 10 = 25 \text{ kcal} \rightarrow 1 \text{ pikë}</math></b></p> <p><b>Kormoranët do të marrin vetëm 10% të energjisë së nivelit trofik të mëparshëm (energjinë nga troftat):</b></p> <p><b><math>25 \text{ kcal} \times 10\% = 2,5 \text{ kcal}</math></b></p> <p><b>ose</b></p> <p><b><math>25 \text{ kcal} \div 10 = 2,5 \text{ kcal} \rightarrow 1 \text{ pikë}</math></b></p>
--

2 pikë

11. Faktorët biotikë përfshijnë të gjithë organizmat e gjallë dhe marrëdhëniet e tyre të ndërsjella brenda një ekosistemi. Organizmat vazhdimisht ndikojnë njëri-tjetrin përmes ushqyerjes, konkurrencës, mbrojtjes dhe bashkëjetesës. Këto ndërveprime janë të rëndësishme për ruajtjen e ekuilibrit në natyrë, sepse çdo organizëm ka një rol të caktuar në ekosistem.

Duke u bazuar në njohuritë tuaja, plotësoni tabelën më poshtë në mënyrë që në fushën bosh pranë çdo pohimi të vendosni vetëm një NUMËR nga lista e faktorëve biotikë. I njëjti numër mund të përdoret më shumë se një herë në tabelë.

1. Konkurrencë
2. Predacion (grabitqarësi)
3. Mutualizëm
4. Komensalizëm
5. Parazitizëm

POHIME	Numri
Dy lloje të ndryshme peshqish që jetojnë në të njëjtin lum ushqehen kryesisht me të njëjtin lloj larvash insektesh. Kur numri i larvave në lum zvogëlohet, numri i të dy popullatave të peshqve bie.	<b>1</b>
Disa delfinë përdorin një teknikë shumë të pazakontë gjuetie duke formuar një unazë me baltë. Një delfin noton në rreth rreth një tufe peshqish dhe godet fort me bisht shtratin e detit, duke ngritur një unazë balte. Peshqit frikësohen se janë të bllokuar dhe instinktivisht kërcejnë mbi unazë për të shpëtuar. Në atë moment, delfinët e tjerë i presin jashtë rrethit dhe i gjuajnë lehtë.	<b>2</b>
Një shqiponjë lëshon 3 vezë gjatë periudhës mars–prill. Të vegjlit zhvillohen për rreth 40 ditë. Në fazat e hershme, ata janë të verbër dhe plotësisht të varur nga prindërit. Pas një kohe, njëri nga zogjtë fillon t'i kafshojë për qafë ose t'i shtyjë të tjerët jashtë folesë, duke bërë që ata të vdesin.	<b>1</b>
Likenët janë një grup organizmash të përbërë nga një kërpudhë dhe një algë. Kërpudhat sigurojnë ujë dhe minerale dhe shërbejnë si shtëpi për algat, të cilat përmes fotosintezës krijojnë lëndë organike.	<b>3</b>
Disa lloje të midhjeve të ujërave të ëmbla nga familja Unionidae, në një fazë të caktuar të zhvillimit të tyre jetojnë në verëzat e peshqve ku ushqehen, rriten dhe zhvillohen në midhje të rritura. Në këtë rast, te këta peshq vërehet vështirësi në frymëmarrje.	<b>5</b>
Disa lloje të Pseudoscorpiones (akrepa të rremë) ngjiten në qimet e gjitarëve të vegjël me ndihmën e kthetrave të quajtura pedipalpa. Gjitarëve nuk u pengon që ata t'i përdorin vetëm për transport.	<b>4</b>

**6 pikë**